



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1404/ 8 prot.

Datë 18.06. 2024

V E N D I M

Nr. 691 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.06.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-04209-05-09-2024, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “ARTEO 2018” SHPK me Nipt. L82523203F. Adresa: Lagjja “Luigj Gurakuqi”, Bulevardi “Aqif Pasha”, Hotel “Skampa”, kati 5 nr. 303, Elbasan.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A. Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të

Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi ankesën e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-04209-05-09-2024, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), më datë 28.05.2024, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, me rezultatet si më poshtë vijon:

1. ARTEO 2018 SHPK	me ofertë	8,979,400	Lek pa TVSH	skualifikuar
2. 2 AS Invest SHPK	“	9,000,000	“	kualifikuar
3. Jonida Muço P.F	“	9,556,772	“	skualifikuar
4. BLINFIRE SHPK	“	9,733,111	“	skualifikuar

II.3. Operatorit ekonomik ankimues “ARTEO 2018” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi, me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“-OE, “Arteo 2018” SHPK, me NIPT: L82523203F, nga dokumentacioni i kërkuar për kualifikim, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë, sipas të gjitha kërkesave të Autoritetit Kontraktor, dhe nuk përmbush:

1. “2.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për mallrat objekt - prokurimi. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.”

2.4 OE duhet të jetë i certifikuar dhe të disponojë certifikatat: b) ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit;

Certifikata në asnjë nga fushat e saj nuk përmend artikujt për tregti me shumicë dhe pakisë për materiale elektrike, objekt i këtij prokurimi.”

II.4. Autoriteti kontraktor ka publikuar *Njoftim - fituesi paraprak*, më datë 29.05.2024, në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4147, datë 03.06.2024, dhe me Nr. 1404/2024 Prot., date 03.06.2024, e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-04209-05-09-2024, me objekt “Blerje materiale elektrike”, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1404/2 Prot., datë 04.06.2024.

II.7. Me shkresën nr. 1290/1 prot, datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1404/3 prot, datë 05.06.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SH.A, ka dërguar informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku përcjell trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Refeuar shkresës sipër cituar, në mënyrë të përmbledhur informon se: [...] *Ju vemë në dijeni se ankesa e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK nuk është e shoqëruar me mandat pagesën, mbështetur në nenin 111, “Paraqitja e ankesës” pika 2, e Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, AK në zbatim të ligjit do të njoftojë operatorin ekonomik “ARTEO 2018” SHPK.*

II.8. Me shkresën Nr. 1404/4 prot., datë 11.06.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion”, drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, në mënyrë të përmbledhur kërkon:

“Pranë Komisionit ka mbërritur shkresa nr. 1290/1 prot., datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1404/3, datë 05.06.2024 me objekt « Informacion » nga autoriteti kontraktor, mbi trajtimin e ankesës sipërcituar, si edhe konstatimin e të metave të ankesës, për mungesën e dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Për sa më sipër, kërkojmë të na informoni në lidhje me veprimet procedurale të kryera nga autoriteti juaj kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 111/3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor të dërgojë pranë KPP-së brenda 2 ditëve nga marrja dijani e kësaj shkrese, informacionin e nevojshëm, si edhe dokumentacionin e komunikimeve midis AK -së dhe ankimuesit, mbi korrigjimin e të metave të ankesës. “

II.9. Me shkresën nr. 1290/4 prot, datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1404/5 prot, datë 14.06.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A, ka dërguar informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me anë të së cilës informon mbi veprimet e marra nga AK në përgjigje të “Kërkesës për Informacion” me nr. 1404/4 prot, datë 11.06.2024 të KPP-së si vijon:

- [...] Në lidhje me shkresën Tuaj të datës 11.06.2024, Ju informojmë se OE ‘Arteo 2018’ shpk e ka marrë njoftimin tonë në dt. 05.06.20, dhe deri më sot, dt 12.06.2024 nuk ka kryer asnjë veprim apo komunikim me ne si AK.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka bashkëlidhur fotokopje të shkresës dërguar OE ankimues:

- AK ka dërguar shkresën, me nr. 1280/2 prot., datë 04.06.2024, me objekt: Njoftim mbi ankesën e OE ARTEO 2018 SHPK, drejtuar: OE ARTEO 2018 SHPK me anë të së cilës e ve në dijeni në mënyrë të përmbledhur informon se: [...] AK në ankesën e paraqitur nga ana juaj, nuk gjen të dokumentuar mandatin e pagesës që bëbhet në rastet e ankimimit sipas ligjeve në fuqi. Në formularin e publikuar në sistemin elektronik të ankesave të KPP-së, emërtimi: “Vlera korresponduese e shifrës së paguar për ankesën” është pa të dhëna, sikundër nuk gjendet në një formë tjetër të publikuar, mandat pagesa për ankesën e mësipërme.

Në zbatim të nenit 111, “Paraqitja e ankesës” pika 2, e Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe të nenit 94/3 “Paraqitja e ankesës” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, AK ju ve në dijeni duke ju kujtuar këtë detyrim ligjor. Ky njoftim i është dërguar edhe KPP-së. [...]

- Autoriteti kontraktor ka bashkëlidhur fotokopje të dokumenteve:

-Lajmërim marrje nr.1290/2 me datë 04.06.2024, lëshuar nga zyra Posta Shqiptare sh.a Elbasan.

-Dërgesa postare me datë 05.06.2024 për dijeni të OE “ARTEO 2018”, Elbasan.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur, Operatori Ekonomik ankimues “ARTEO 2018” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e ofertës së tij, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“-OE, “Arteo 2018” shpk, me NIPT: L82523203F, nga dokumentacioni i kërkuar për kualifikim, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë, sipas të gjitha kërkesave të Autoritetit Kontraktor, dhe nuk përmbush:

1. “2.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për mallrat objekt - prokurimi. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.”

2.4 OE duhet të jetë i certifikuar dhe të disponojë certifikatat: b) ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit;

Certifikata në asnjë nga fushat e saj nuk përmend artikujt për tregti me shumicë dhe pakisë për materiale elektrike, objekt i këtij prokurimi.”

III.1.1. Nga shqyrtimi i ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që të vërtetojë, se ka kryer pagesën e tarifës financiare për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me përcaktimet në pikat 2 dhe 4 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.1.2. Në nenin 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar se:
“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

Gjithashtu në gjurmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”.

III.1.3. Me shkresën nr. 1290/1 prot, datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1404/3 prot, datë 05.06.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A, ka dërguar informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku përcjell trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Refeuar shkresës sipër cituar, në mënyrë të përmbledhur informon se:

[...] Ju vemë në dijeni se ankesa e operatorit ekonomik “ARTEO 2018” SHPK nuk është e shoqëruar me mandat pagesën, mbështetur në nenin 111, “Paraqitja e ankesës” pika 2, e Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, AK në zbatim të ligjit do të njoftojë operatorin ekonomik “ARTEO 2018” SHPK.[...]

III.1.4. Me shkresën Nr.1404/4 prot., datë 11.06.2024, me objekt “Kërkesë për Informacion” drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, në mënyrë të përmbledhur kërkon:

“Pranë Komisionit ka mbërritur shkresa nr. 1290/1 prot., datë 04.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 1404/3, datë 05.06.2024, me objekt « Informacion » nga autoriteti kontraktor, mbi trajtimin e ankesës sipërcituar, si edhe konstatimin e të metave të ankesës, për mungesën e dokumentit bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Për sa më sipër kërkojmë të na informoni në lidhje me veprimet procedurale të kryera nga autoriteti juaj kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 111/3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor të dërgojë pranë KPP-së brenda 2 ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, informacionin e nevojshëm si edhe dokumentacionin e komunikimeve midis AK -së dhe ankimuesit, mbi korrigjimin e të metave të ankesës.”

III.1.5. Me shkresën nr. 1290/4 prot, datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1404/5 prot, datë 14.06.2024, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A., ka dërguar informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Informon mbi veprimet e marra nga AK në përgjigje të “Kërkesë për Informacion” me nr. 1404/4 prot, datë 11.06.2024, të KPP-së si vijon:

• [...] Në lidhje me shkresën Tuaj të datës 11.06.2024, Ju informojmë se OE ‘Arteo 2018’ SHPK e ka marrë njoftimin tonë në dt. 05.06.20, dhe deri më sot, dt 12.06.2024 nuk ka kryer asnjë veprim apo komunikim me ne si AK.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka bashkëlidhur fotokopje të shkresës dërguar OE ankimues:

- *AK ka dërguar shkresën, me nr. 1280/2 prot., datë 04.06.2024 me objekt: Njoftim mbi ankesën e OE ARTEO 2018 SHPK, drejtuar: OE ARTEO 2018 SHPK me anë të së cilës e ve në dijeni në mënyrë të përmbledhur informon se: [...] AK në ankesën e paraqitur nga ana juaj, nuk gjen të dokumentuar mandatin e pagesës që bëbhet në rstet e ankimit sipas ligjeve në fuqi. Në formularin e publikuar në systemin elektronik të ankesave të KPP-së, emërtimi: “Vlera korresponduese e shifrës së paguar për ankesën” është pa të dhëna, sikundër nuk gjendet në një formë tjetër të publikuar, mandat pagesa për ankesën e mësipërme.*

Në zbatim të nenit 111, “Paraqitja e ankesës” pika 2, e Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe të nenit 94/3 “Paraqitja e ankesës” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, AK Ju ve në dijeni duke ju kujtuar këtë detyrim ligjor. Ky njoftim i është dërguar edhe KPP-së. [...]

- Autoriteti kontraktor ka bashkëlidhur fotokopje të dokumenteve:

*-Lajmërim marrje nr. 1290/2 me datë 04.06.2024, lëshuar nga zyra e Posta Shqiptare sh. a, Elbasan.
-Dërgesa postare me datë 05.06.2024 për dijeni të OE “ARTEO 2018”, Elbasan.*

III.1.6. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se në legjislacionin e prokurimeve publike janë përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar shkresave të mësipërme rezultojnë, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, duke i kërkuar operatorit ekonomik ankimes “ARTEO 2018” SHPK ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën me nr. 1404/2024 prot., datë 03.06.2024, me përmbajtje si më sipër cituar në pikën III.1.5.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër

parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor, thekson, se ky i fundit ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues nëpërmjet postës si mjet komunikimi, dhe vërtetuar me dokumentet postare në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, atë të pagesës së tarifës së ankesës.

Në këto kushte, Komisioni, pasi kreu verifikimet në Sistemin elektronik të ankesave, konstatoi se ankimuesi nuk ka depozituar dokumentin mandat - pagesë për ankesën. Komisioni, referuar fakteve gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk është privuar nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme. Fakti që ai ka refuzuar ndreqjen e të metave, si në rastin konkret pagimin e tarifës së ankesës, nuk e ka privuar këtë të fundit nga një prej të drejtave më themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit.

Referuar arsytimit, në kushtet kur operatori ekonomik ankimues nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës, si dhe ka refuzuar ndreqjen e të metave sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik *“ARTEO 2018”* SHPK nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës, ndaj bazuar në gërmën *“a”*, të pikës 2, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, kjo ankesë duhet refuzuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik *“ARTEO 2018”* SHPK, për procedurën e prokurimit. *“Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”*, me Nr REF-04209-05-09-2024, me objekt *“Blerje materiale elektrike”*, me fond limit: 9,994,647 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

